

VENDIM
Nr.69, datë 7.2.2007

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I AKSIT RRUGOR,
QË LIDH RRUGËN KOMBËTARE GOSTIMË-MOLLAS ME URËN E RE MBI LUMIN
SHICË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i aksit rrugor, që lidh rrugën kombëtare Gostimë-Mollas me urën e re mbi lumin Shicë.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, për sipërfaqen 1350 m² tokë/arë, e vlerësuar me 700 lekë/m², dhe kultura/jonxhë, e vlerësuar me 6750 lekë, e vlerësuar në shumën e përgjithshme 951 750 (nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Shpenzimet procedurale, në shumën 123 000 (njëqind e njëzet e tre mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 951 750 (nëntëqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekësh, të përballohet nga llogaria speciale, e krijuar si transfertë kapitale për t’u përdorur për shpronësime.

6. Shpronësimi të fillojë e të përfundojë brenda muajit mars 2007.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit, të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.

8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I LIDHJES SË RRUGËS
NACIONALE GOSTIMË-MOLLAS ME URËN E RE MBI LUMIN SHICË**

Nr.	Emri	Zona kadastrale	Pasuria	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m²	Vlera në lekë	Kultura jonxhë Vlera në lekë	Vlera totale e shpronësimit
1.	Xhevahir Xhevit Gjini	1452	67/84	320	700	224 000	1 600	225 600
2.	Ilmi Agim Cërriku	1452	67/72	460	700	322 000	2 300	324 300
3.	Bashkëpronarët	1452	67/86	570	700	399 000	2 850	401 850

	Gjini							
	Shuma			1 350		945 000	6 750	951 750

Totali: 951 750 lekë.